



EPIDEMIOLOGJIA E SËMUNDJEVE PERIODONTALE

Lumturije Asllani¹, Ana Minovska², Mihajlo Petrovski³, Merita Barani⁴, Doruntina Shehu⁵, Elsa Hashani⁶

¹Faculty of Medical Sciences, Goce Delcev University, Stip, North Macedonia
lumturie.31175@student.ugd.edu.mk

²EternaDent, Skopje, North Macedonia
aminovska@yahoo.com

³Faculty of Medical Sciences, Goce Delcev University, Stip, North Macedonia
mihajlo.petrovski@ugd.edu.mk

⁴Faculty of dentistry of UBT, Prishtine, Kosova
merita.barani@ubt-uni.net

⁵Faculty of Medical Sciences, Goce Delcev University, Stip, North Macedonia
doruntina.311108@student.ugd.edu.mk

⁶Student at the Faculty of dentistry UBT, Prishtine, Kosova
hashanielsa3@gmail.com

ABSTRAKT

Sëmundje periodontale është një term i përgjithshëm për të gjitha sëmundjet që prekin indet që rrethojnë dhe mbështesin dhëmbët në nolla.

Sëmundjet periodontale klasifikohen në dy lloje: gingiviti, i cili prek vetëm gingivat dhe parodontopatia, e cila prek indet mbështetëse periodontale themelore. Sëmundjet periodontale mund të jenë të trashëgueshme ose të fituara. Parodontiumi përbëhet nga katër inde: gingiva, cimentoja, ligamentet periodontale dhe kocka alveolare.

Gingiviti manifestohet me inflamacion, skuqje dhe gjakderdhje në mishrat e dhëmbëve. Parodontopatia është fazë e avancuar e sëmundjeve periodontale, në të cilën mishrat e dhëmbëve shpesh shpëputen nga dhëmbi, ndodh resorbimi i kockës alveolare dhe dhëmbët lëvizin ose bien.

Infeksionet periodontale janë ndër sëmundjet kronike më të shpeshta që kanë prekur njerëzit për breza. Parodontopatia është shkak më i përhapur i humbjes së dhëmbëve tek të rriturit. Gjatë dy dekadave të fundit, është arritur përparim i konsiderueshëm në kuptimin e shkakut, patofiziologjisë dhe trajtimit të sëmundjes periodontale. Studimet e vazhdueshme tregojnë se sëmundjet periodontale mund të shmangen, të trajtohen nëse shfaqen dhe dhëmbët mund të ruhen për një jetë të tërë.

Fjalë kyçe: gingivit, sëmundje parodontale, parodontopatia.

EPIDEMIOLOGY OF PERIODONTAL DISEASES

Lumturije Asllani¹, Ana Minovska², Mihajlo Petrovski³, Merita Barani⁴, Doruntina Shehu⁵, Elsa Hashani⁶

¹Faculty of Medical Sciences, Goce Delcev University, Stip, North Macedonia
lumturie.31175@student.ugd.edu.mk

²EternaDent, Skopje, North Macedonia
aminovska@yahoo.com

³Faculty of Medical Sciences, Goce Delcev University, Stip, North Macedonia
mihajlo.petrovski@ugd.edu.mk

⁴Faculty of dentistry of UBT, Prishtine, Kosova
merita.barani@ubt-uni.net

⁵Faculty of Medical Sciences, Goce Delcev University, Stip, North Macedonia
doruntina.311108@student.ugd.edu.mk

⁶Student at the Faculty of dentistry UBT, Prishtine, Kosova
hashanielsa3@gmail.com

ABSTRACT

Periodontal disease is a general term for all illnesses affecting the tissues that surround and support the teeth in the jaws.

Periodontal disease is classified into two types: gingivitis, which affects only the gingiva and periodontitis, which affects the underlying supporting periodontal tissues.

Periodontal disease can be hereditary or acquired. The periodontium is made up of four distinct tissues: gingiva, cementum, periodontal ligament, and alveolar bone.

Gingivitis causes inflammation, redness and bleeding in the gum in its early stages. Periodontitis is the advanced stage of periodontal disease in which the gums tear away from the tooth, bone loss occurs, and teeth become loose or fall out.

Periodontal infections are among the most frequent chronic illnesses that have afflicted humans for generations.

Periodontitis is the most prevalent cause of tooth loss in adults. Throughout the last two decades, significant progress has been achieved in understanding the cause, pathophysiology, and treatment of periodontal disease. Longitudinal studies show that periodontal disease can be avoided, treated if it arises, and teeth can be kept for a lifetime.

Keywords: gingival diseases, periodontal disease, periodontitis



HYRJE

Sëmundjet periodontale përfaqësojnë një grup sëmundjesh të trashëguara ose të fituara të periodontit. Periodontipërbbëhetngakatër llojetëndryshme indesh: gingiva, cimento, ligamentet periodontale dhe kockë alveolare. Parodontopatia shkaktohet kryesisht nga infeksionet dhe inflamacioni i mishrave të dhëmbëve dhe kockave që rrethojnë dhe mbështesin dhëmbët. Në fazat e hershme, të njohura si gingivit, mishrat e dhëmbëve mund të fryhen, të skuqen dhe të kenë gjakderdhje. Parodontopatia është një formë më serioze e sëmundjes periodontale, në të cilën mishrat e dhëmbëve shpëputen nga dhëmbi, kocka humbet dhe dhëmbët lëvizin ose bien. Të rriturit kanë më shumë gjasa të preken nga sëmundjet periodontale.

Faktorët gjenetikë dhe mjedisorë luajnë gjithashtu një rol në ndjeshmërinë ose rezistencën ndaj sëmundjeve periodontale. Higjiena e mirë orale është çelësi për parandalimin e sëmundjeve periodontale. Incidenca e gingivitit mund të reduktohet me anë të kontrollit adekuat të pllakut dentar. Procedurat e pastrimit mekanik dhe larjes me furçë e largojnë në mënyrë efektive biofilmin. Edukimi dhe motivimi i fëmijëve nga dentistët dhe profesionistët që duhet të krijojnë higjienë të përshtatshme orale është thelbësore. Larja e dhëmbëve me një frekuencë prej të paktën dy herë në ditë, duhet të fillohet në kohën kur del dhëmbi i parë dhe të vendoset si rutinë në kohën kur dalin molarët primarë. Për fëmijët parashkollorë, masat e higjienës orale duhet të përqendrohen në heqjen efektive mekanike të pllakut dentar, duke përdorur furçë dhëmbësh manuale ose elektrike nën mbikëqyrjen e prindërve. Furçat e dhëmbëve me karakteristika të veçanta dizajni për fëmijët, mund të përmirësojnë teknikën e larjes së dhëmbëve dhe të rrisin motivimin individual (15).

QËLLIMI

Qëllimi kryesor i këtij punimi ishte të kryente një rishikim të literaturës mbi karakteristikat themelore epidemiologjike të manifestimeve dhe sëmundjeve të ndryshme periodontale.

INTRODUCTION

Periodontal diseases represent a group of inherited or acquired diseases of the periodontium. The periodontium consists of four different types of tissues gingiva, cementum, periodontal ligament and alveolar bone. Periodontitis is caused mostly by infections and inflammation of the gums and bone that surround and support the teeth.

In its early stages, known as gingivitis, the gums might become swollen, red and bleed. Periodontitis is a more serious form of periodontal disease in which the gums pull away from the tooth, bone is lost and teeth loosen or fall out. Adults are more likely to get periodontal disease.

Genetic and environmental factors also play a role in periodontal disease susceptibility or resistance. Good oral hygiene is key to preventing periodontal disease. The incidence of gingivitis can be reduced by adequate control of dental plaque. Mechanical cleaning and brushing procedures effectively remove the biofilm.

Education and motivation of children by dentists and professionals who need to establish adequate oral hygiene is essential. Brushing the teeth at a frequency of at least twice a day should be introduced at the time the first tooth erupts and be established as a routine by the time the primary molars erupt. For preschool children, oral hygiene measures should focus on effective mechanical plaque removal using a manual or electric toothbrush under parental supervision. Toothbrushes with special design features for children can improve brushing technique and increase individual motivation (15).

AIM

The main aim of this paper was to conduct a literature review on the basic epidemiological characteristics of different periodontal manifestations and diseases.



Epidemiologjia e sëmundjeve periodontale

Çrregullimet periodontale janë të zakonshme, si në vendet e industrializuara ashtu edhe në ato në zhvillim, duke prekur 20-50% të popullsisë globale. Sëmundjet periodontale janë shqetësim për shëndetin publik për shkak të prevalencës së saj të lartë tek adoleshentët, të rriturit dhe të moshuarit. Çrregullimet periodontale shoqërohen me një numër faktorësh rreziku, duke përfshirë pirjen e duhanit, higjienën e dobët orale, diabetin, medikamentet, moshën, trashëgiminë dhe stresin. Sëmundjet periodontale janë çrregullimet më të shpeshta orale tek njerëzit. Vlerësimet e prevalencës dhe incidencës së sëmundjeve periodontale luhaten për shkak të paragjytimeve, klasifikimit të gabuar të rasteve dhe numrit të dhëmbëve dhe vendeve të hulumtuara. Matja e humbjes së ngjitjes klinike periodontale (CAL) konsiderohet si standardi i artë në vlerësimin e prevalencës së sëmundjeve periodontale, sipas Anketës Kanadeze të Masave Shëndetësore 2007-2009. Humbja e ngjitjes (CAL) dhe thellësia e sondimit u matën nga Anketa Kombëtare e Ekzaminimit të Shëndetit dhe Ushqyerjes (NHANES) në Shtetet e Bashkuara, sëmundja periodontale u vlerësua në gjashtë vende në të gjithë dhëmbët (duke përfshirë molarët e tretë) (7).

Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) ka një depo globale të të dhënave të shëndetit oral që bazohet në indeksin parodontal të komunitetit (CPI).

Këto të dhëna globale të shëndetit oral u mbledhën nga hulumtime të mëdha epidemiologjike nga shumë vende për të treguar shpërndarjen e sëmundjeve periodontale tek adoleshentët, të rriturit dhe popullatat e moshuara. Rezultati i indeksit CPI, i cili varion nga 0 në 4, përfaqëson shëndetin periodontal të njerëzve në nivel popullate. Rezultati i CPI 0 tregon mungesën e sëmundjeve periodontale; rezultati 1 zbulon gjakderdhje nga mishrat e dhëmbëve gjatë sondimit; rezultati 2 tregon gurëza dhe gjakderdhje; rezultati 3 tregon xhepa periodontal të cekët prej 4-5 mm; dhe rezultati 4 tregon xhepa të thellë parodontal prej 6 mm ose më të thellë (19).

Në vendet e pazhvilluara, përqindja e adoleshentëve që kishin depozita gurësh varionte nga 35% në 70%, ndërsa varionte nga 4% në 34% në vendet e pasura.

Epidemiology of periodontal disease

Periodontal disorders are common in both industrialized and developing countries, affecting 20-50% of the global population. Periodontal disease is a public health concern due to its high prevalence in adolescents, adults and the elderly. Periodontal disorders are associated with a number of risk factors, including smoking, poor oral hygiene, diabetes, medication, age, heredity and stress. Periodontal disease is the most frequent oral disorder among humans. Periodontal disease prevalence and incidence estimates fluctuate due to bias, case misclassification and the number of teeth and sites investigated. The measurement of periodontal clinical attachment loss (CAL) is regarded as the gold standard in assessing the prevalence of periodontal disease, according to the Canadian Health Measures Survey 2007-2009. The attachment loss (CAL) and probing depth were measured by the National Health and Nutrition Examination Survey (NHANES) in the United States; periodontal disease was estimated at six sites on all teeth (excluding third molars) (7).

The World Health Organization (WHO) has a global oral health data repository that is based on the community periodontal index (CPI).

This global oral health data was gathered from big epidemiological research from many nations to show the distribution of periodontal disease in adolescents, adults, and elderly populations. The CPI index score, which ranges from 0 to 4, represents the periodontal health of people at the population level. CPI score 0 indicates no periodontal disease; score 1 reveals gingival bleeding on probing; score 2 indicates calculus and bleeding; score 3 suggests shallow periodontal pockets of 4-5 mm; and score 4 indicates deep periodontal pockets of 6 mm or greater (19).

In underdeveloped countries, the proportion of teenagers having calculus deposits ranged from 35% to 70%, while it ranged from 4% to 34% in wealthy ones. Similarly, 14-47% of individuals in rich countries had calculus deposits, but 36-63% of adults in impoverished countries had. Yet, affluent countries have a higher proportion of those with periodontal pockets of 4-5 mm. When compared to adult populations in both industrialized and



Në mënyrë të ngjashme 14-47% e individëve në vendet e pasura kishin depozita gurësh, por 36-63% e të rriturve kishin në vendet e varfëra. Megjithatë, vendet e pasura kanë një përqindje më të lartë të atyre me xhepa parodontalë prej 4-5 mm. Krahësuar me popullatat e të rriturve si në vendet e industrializuara ashtu edhe në ato në zhvillim, një përqindje më e lartë e të moshuarve (65-74 vjeç) kanë xhepa parodontalë prej 6 mm ose më të thellë. Sëmundjet periodontale prekin rreth 20-50% të popullsisë globale (17).

Sëmundjet e rënda periodontale vlerësohet, se ndikojnë mbi 19% të popullsisë së rritur globale, me mbi 1 miliard raste në të gjithë botën (19).

Një raport i ri i CDC-së (Qendra për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve) ofron faktet e mëposhtme mbi prevalencën e periodontitit në Shtetet e Bashkuara:

- Sëmundja periodontale prek 47.2% të personave mbi moshën 30 vjeç.
- Sëmundja periodontale bëhet më e përhapur me moshën, 70.1% e personave 65 vjeç e lartë kanë sëmundje periodontale.
- Burrat kanë më shumë gjasa, sesa gratë të kenë këtë sëmundje (56.4% kundrejt 38.4%), si dhe ata që jetojnë në kushte të varfërisë (65.4%), ata me arsim më pak se të mesëm (66.9%), dhe duhanpirësit (64.2%) (7).

Sëmundjet periodontale vazhdojnë të jenë një problem i madh i shëndetit publik në Shtetet e Bashkuara, me 2 në 5 persona, që vuajnë nga ndonjë formë e sëmundjes. Disa grupe të popullsisë vazhdojnë të përballen me dallime të konsiderueshme dhe pirja e duhanit mbetet një faktor kyç rreziku për periodontin.

Prevalenca e parodontopatisë, siç përcaktohet nga përkufizimet e rasteve të CDC/AAP, në Shtetet e Bashkuara, 42.2% (gabim standard, 1.4) e personave 30 vjeç e lartë kishin parodontopati të plotë, me 7.8% që kishin parodontopati të rëndë dhe 34.4% që kishin parodontopati jo të rëndë.

Parodontopatia kronike ishte më e zakonshme tek burrat (50.2%), meksikano-amerikanët (59.7%), individët që fitonin më pak se 100% të FPL (60.4%), duhanpirësit aktualë (62.4%) dhe ata me diabet (59.9%).

Frekuenca e parodontopatisë ishte më e larta tek

developing countries, a higher proportion of older people (65-74 years) have periodontal pockets of 6 mm or greater. Periodontal disease affects around 20-50% of the global population (17).

Severe periodontal diseases are estimated to impact over 19% of the global adult population, with over 1 billion cases worldwide (19).

A new CDC (Center for disease control and prevention) report provides the following facts on periodontitis prevalence in the United States:

- Periodontal disease affects 47.2% of persons over the age of 30.
- Periodontal disease becomes more prevalent with age; 70.1% of persons 65 and older have periodontal disease.
- Men are more likely than women to have this ailment (56.4% vs 38.4%), as are those living below the federal poverty line (65.4%), those with less than a high school education (66.9%), and current smokers (64.2%) (7).

Periodontal (gum) disease continues to be a major public health issue in the United States, with 2 in 5 persons suffering from some form of the illness. Certain population groups continue to face significant differences, and smoking remains a key risk factor for periodontitis.

Periodontitis prevalence as defined by the CDC/AAP case definitions, in the United States, 42.2% (standard error, 1.4) of persons 30 years or older had complete periodontitis, with 7.8% having severe periodontitis and 34.4% having non severe periodontitis.

Chronic periodontitis was most common in men (50.2%), Mexican Americans (59.7%), individuals earning less than 100% of the FPL (60.4%), current smokers (62.4%), and those with diabetes (59.9%).

The frequency of generalized periodontitis was highest among people who did not use dental floss regularly (53.1%) and increased with increasing duration since last dental appointment to 54.8% of those who had not visited the dentist in the previous year (5).

Different forms of periodontal diseases can occur in children and adolescents. Children are not only susceptible to reversible diseases that affect the



njerëzit që nuk përdornin fije dentare rregullisht (53.1%) dhe u rrit me rritjen e kohëzgjatjes që nga vizita e fundit dentare në 54.8% të atyre që nuk kishin vizituar dentistin vitin e kaluar (5).

Forma të ndryshme të sëmundjeve periodontale mund të shfaqen tek fëmijët dhe adoleshentët. Fëmijët jo vetëm që janë të ndjeshëm ndaj sëmundjeve të kthyesme që prekin indet gingivale dhe periodontale, por mund të ndodhë edhe shkatërrim i shpejtë i periodontit, gjë që mund të ndikojë në jetëgjatësinë e dhëmbëve të qumështit ose të përhershëm (1).

Fëmijët dhe adoleshentët kanë një rrezik për një gamë të gjerë sëmundjesh periodontale. Sëmundjet periodontale, të tilla si inflamacioni i gingivës i shkaktuar nga pllaku dentar dhe jo i shkaktuar nga pllaku dentar, sëmundjet periodontale, si manifestim i sëmundjes sistemike dhe sëmundjet periodontale nekrotizuese, mund të ndodhin tek pacientët e moshuar. Parandalimi, diagnoza e hershme dhe trajtimi i hershëm për sëmundjet periodontale tek fëmijët dhe adoleshentët janë të rëndësishme. Nëse nuk trajtohen, lezionet fillestare parodontale tek fëmijët dhe adoleshentët mund të zhvillohen sëmundje periodontale të avancuara në kohën kur ata bëhen të rritur. Studime të shumta tregojnë lidhje midis sëmundjeve periodontale dhe sistemike. Fëmijët me sëmundje të caktuara sistemike shpesh vuajnë nga forma më shkatërruese të sëmundjeve periodontale, në krahasim me të rriturit (5).

Gingiviti

Gingiviti është një lloj sëmundjeje periodontale që nuk është e dëmshme. Kjo zakonisht quhet sëmundje e mishrave të dhëmbëve. Gingiviti është një fazë e hershme e sëmundjes së mishrave të dhëmbëve me simptoma relativisht minimale.

Nëse gingiviti nuk trajtohet siç duhet, mund të kalojë në parodontopati. Grumbullimi i pllakut bakterial ndërmjet dhe rreth dhëmbëve është shkaku më i përhapur i gingivitit. Pllaku dentar është një biofilm që formohet natyrshëm në dhëmbë. Kjo ndodh kur bakteret ngjiten në sipërfaqen e lëmuar të një dhëmbi. Rreth mishrave të dhëmbëve në bazën e dhëmbëve,

gingival and periodontal tissues, but rapid destruction of the periodontium can occur, which can affect the longevity of the deciduous or permanent dentition (1).

Children and adolescents have a risk of a wide variety of periodontal diseases. Periodontal diseases such as plaque-induced and non-plaque-induced gingival inflammation, periodontal disease, periodontal disease as a manifestation of systemic disease and necrotizing periodontal disease can occur in these aged patients. Prevention, early diagnosis and early treatment for periodontal diseases among children and adolescents are important. If untreated, initial periodontal lesions in children and adolescents can develop into advanced periodontal disease by the time they become adults. Numerous studies show associations between periodontal and systemic diseases. Children with certain systemic diseases often suffer from more destructive forms of periodontal diseases, in comparison with adults (5).

Gingivitis

Gingivitis is a kind of periodontal disease that is not harmful. This is commonly referred to as gum disease. Gingivitis is an early stage of gum disease with relatively minimal symptoms.

If gingivitis is not appropriately treated, they might proceed to periodontitis. The collection of bacterial plaque between and around the teeth is the most prevalent cause of gingivitis. Dental plaque is a biofilm that naturally forms on the teeth. It happens when bacteria attach themselves to the smooth surface of a tooth.

Around the gums at the base of the teeth, plaque can harden into calculus, or tartar. This is yellow-white in color. Plaque and tartar can cause immunological responses that result in gingival or gum tissue loss.

Other causes and risk factors are hormone fluctuations that can occur during puberty, menopause, the menstrual cycle, and pregnancy. Gums may become more sensitive, increasing the likelihood of irritation. Certain disorders, like cancer, diabetes, and HIV, have been linked to an increased incidence of gingivitis.



pllaku dentar mund të ngurtësohet në gur ose tartar, ka ngjyrë të verdhë dhe të bardhë. Pllaku dentar dhe tartari mund të shkaktojnë përgjigje imunologjike që rezultojnë në humbje të indeve gingivale ose të mishrave të dhëmbëve.

Shkaqe dhe faktorë të tjerë rreziku janë luhatjet hormonale që mund të ndodhin gjatë pubertetit, menopauzës, ciklit menstrual dhe shtatzënisë. Mishrat e dhëmbëve mund të bëhen më të ndjeshëm, duke rritur mundësinë e acarimit. Disa çrregullime, si kanceri, diabeti dhe HIV, janë lidhur me një incidencë në rritje të gingivitit.

Gingiviti i shoqëruar me hormonet steroide (seksuale) paraqitet si gingivit pubertal. Ai shoqërohet me nivele të larta të hormoneve që amplifikojnë ndryshimet klinike inflamatore të gingivitit paraekzistues. Bakteriet e biofilmit dentar janë të nevojshme për të filluar këtë sëmundje gingivale. Variacionet normale dhe anormale në nivelet e hormoneve, duke përfshirë ndryshimet në nivelet e hormoneve gonadotropinë, estrogenit dhe progesteronit gjatë fillimit të pubertetit, shtatzënisë ose periudhave të caktuara të ciklit menstrual, ose tek pacientët që marrin kontraktivë orale, mund të ndryshojnë përgjigjen inflamatorë të gingivës. Vaskulariteti i gingivës ndryshon dhe inflamacioni i shkaktuar nga pllaku dentar rritet me rritjen e nivelit të hormonit (14).

Sëmundjamaifestohet si njëjtë e papillës interdentalë, me hemorragji spontane gingivale. Heqja e faktorëve lokal është çelësi për menaxhimin e sëmundjes. Profilaksia profesionale dhe heqja e faktorëve lokalë e kombinuar me një regjim të mirë të higjienës orale në shtëpi mund të përmirësojë gjendjen. Në disa raste, ënjtja e gingivës përparon dhe bëhet fibroze, shkaktohet hiperplazi fibroze e gingivës. Në një rast të tillë, indikohet heqja kirurgjikale e rritjes së tepërt gingivale (gingivoplastikë) (18).

Zmadhimi i gingivës mund të shoqërohet me sëmundje sistematike dhe metabolike, faktorë gjenetikë, faktorë lokalë dhe efekte anësore të disa barnave si ciklosporina (imunosupresuese), fenitoina (antikonvulsante) dhe nifedipina, verapamili dhe amlodipina (bllokues të kanaleve të kalciumit). Rritja e tepërt e gingivës mund të vërehet në 30% të pacientëve që marrin ciklosporinë, 50% të pacientëve

Gingivitis associated with steroid (sex) hormones is present as pubertal gingivitis. It is associated with elevated hormone levels that amplify the clinical inflammatory changes of pre-existing gingivitis. Dental biofilm bacteria are necessary to initiate this gingival disease. Normal and abnormal variations in hormone levels, including changes in gonadotropin hormone, estrogen and progesterone levels during the onset of puberty, pregnancy or certain periods of the menstrual cycle, or in patients receiving oral contraceptives, can alter the gingival inflammatory response answer. The vascularity of the gingiva changes, and the inflammation caused by dental plaque increases as the hormone level increases (14).

The disease manifests as swelling of the interdental papilla, with spontaneous gingival hemorrhage. Removal of local factors is the key to managing the disease. Professional prophylaxis and removal of local factors combined with a good oral hygiene regime at home can improve the condition. In some cases, the swelling of the gingiva progresses and becomes fibrous, there is fibrous hyperplasia of the gingiva. In such a case, surgical excision of excessive gingival growth (gingivoplasty) is indicated (18).

Gingival enlargement may be associated with systemic and metabolic diseases, genetic factors, local factors and side effects of some drugs such as cyclosporine (immunosuppressant), phenytoin (anticonvulsant) and nifedipine, verapamil and amlodipine (calcium channel blockers). Gingival overgrowth can be observed in 30% of patients taking cyclosporine, 50% of patients using phenytoin, and 15% of patients treated with calcium channel blockers (13). The pathogenesis of this condition is still uncertain.

Excessive gingival growth begins in the area of the interdental papilla, spreading to the marginal gingiva. In severe cases, the enlarged gingiva may even cover the incisal and occlusal surfaces of the teeth. Histologically, the overgrowth is fibroepithelial in nature, with epithelial acanthosis, increased number of fibroblasts and increased production of collagen.

The management of excessive gingival growth should begin with giving instructions to maintain adequate oral hygiene, professional removal of hard and soft deposits. It is recommended to rinse



që përdorin fenitoinë dhe 15% të pacientëve të trajtuar me bllokues të kanaleve të kalciumit (13). Patogjeneza e kësaj gjendjeje është ende e pasigurt.

Rritja e tepërt e gingivës fillon në zonën e papillës interdentalë, duke u përhapur në gingivën marginale. Në raste të rënda, gingiva e zmadhuar mund të mbulojë edhe sipërfaqet incizale dhe okluzale të dhëmbëve. Histologjikisht, rritja e tepërt është me natyrë fibroepiteliale, me akantozë epiteliale, numër të shtuar të fibroblasteve dhe prodhim të rritur të kolagenit.

Menaxhimi i rritjes së tepërt të gingivës duhet të fillojë me dhënien e udhëzimeve për të ruajtur higjienën orale adekuate, heqjen profesionale të depozitimeve të forta dhe të buta. Rekomandohet shpëlarja e gojës me klorheksidinë. Në rast të zmadhimit të avancuar të gingivës, mund të kërkohej gingivektomi, gingivoplastikë ose ndërhyrje kirurgjikale periodontale, të cilat janë të nevojshme për të korrigjuar konturet e gingivës për arsye estetike. Zmadhimi i gingivës mund të përsëritet edhe pas operacionit. Kontrolli adekuat i pllakut dentar në shtëpi dhe mirëmbajtja e rregullt periodontale është çelësi për të zvogëluar gjasat ose ashpërsinë e përsëritjes (10).

Sipas këtij studimi, prevalenca e gjakderdhjes nga gingiva është 39.3%, më e lartë tek djemtë. Prevalenca e gurëzave dentar është 30.7%, pa ndonjë ndryshim të rëndësishëm midis gjinive. Niveli arsimor i prindërve dhe zakonet e higjienës orale ndikojnë në prevalencën e gingivitit. Fëmijët, prindërit e të cilëve kanë një nivel më të lartë arsimor, kanë zakone më të mira të higjienës orale dhe konsumojnë më pak pije me sheqer (13).

Prevalenca e gingivitit tek fëmijët dhe adoleshentët ndryshon shumë në vende të ndryshme, duke filluar nga 20% në mbi 90%. Shkalla më e lartë u vu re në popullatat me disavantazh socioekonomik. Faktorët kryesorë të rrezikut përfshijnë higjienën e dobët orale, dietat e pasura me sheqer, arsimin e ulët të prindërve, pajisjet ortodontike dhe aksesin e kufizuar në kujdesin parandalues (7).

Gingiviti është inflamacion i mishrave të dhëmbëve, por parodontopatia shkakton humbjen e kockës alveolare, ligamentit periodontal dhe cimentos së

the mouth with chlorhexidine. In case of advanced gingival enlargement, gingivectomy, gingivoplasty or periodontal surgical interventions may be required, which are needed to correct gingival contours for aesthetic reasons. Gingival enlargement can be repeated even after surgery. Adequate home plaque control and regular periodontal maintenance is the key to reducing the likelihood or severity of recurrence (10).

According to this study regarding the prevalence of gingival bleeding is 39.3%, higher in boys. The prevalence of dental calculus is 30.7%, with no significant difference between genders. The educational level of parents and oral hygiene habits affect the prevalence of gingivitis. Children whose parents have a higher educational level have better oral hygiene habits and consume fewer sugary drinks (13).

Gingivitis prevalence among children and adolescents varies widely across countries, ranging from 20% to over 90%. Higher rates were observed in socioeconomically disadvantaged populations. Key risk factors include poor oral hygiene, sugar-rich diets, low parental education, orthodontic appliances, and limited access to preventive care (7).

Gingivitis is a gum-line inflammation, but periodontitis causes loss of the alveolar bone, periodontal ligament, and root cementum. There is no loss of the structures that hold teeth in place in gingivitis. This means that practicing proper oral hygiene at home can help to prevent gingivitis and restore healthy gums. Periodontitis, on the other hand, is a different story. Once the inflammation has caused bone loss, the harm is irreversible.

Periodontitis

Periodontitis is a type of periodontal disease. It is a chronic inflammatory illness caused by bacterial germs that produces severe chronic inflammation that destroys the tooth-supporting apparatus and can lead to tooth loss. It can also cause other health issues.

Periodontitis is always preceded by gingivitis, or gum inflammation. This inflammation, which



rrënjës së dhëmbit. Tek gingiviti nuk ka humbje të strukturave që mbajnë dhëmbët në vend. Kjo do të thotë që praktikimi i higjienës së duhur orale në shtëpi mund të ndihmojë në parandalimin e gingivitit dhe në rivendosjen e mishrave të shëndetshëm. Parodontopatia, nga ana tjetër, është një histori tjetër, pasi inflamacioni të ketë shkaktuar humbje të kockave, dëmi është i pakthyeshem.

Parodontopatia

Parodontopatia është sëmundje periodontale. Është sëmundje kronike inflamatore e shkaktuar nga mikrobet bakteriale që shkaktojnë inflamacion të rëndë kronik, që shkatërron aparatën mbështetëse të dhëmbit dhe mund të shkaktojë humbjen e dhëmbëve. Mund të shkaktojë edhe probleme të tjera shëndetësore.

Parodontopatia gjithmonë paraprihet nga gingiviti ose inflamacioni i mishrave të dhëmbëve. Ky inflamacion, i cili zakonisht manifestohet si mishra të skuqur ose të fryrë dhe gjakderdhje gjatë pastrimit të dhëmbëve ose përtypjes së ushqimit, është reagim i trupit ndaj mikroorganizmave që janë grumbulluar në dhëmbë.

Ky inflamacion mund të zhvillohet më pas në mishrat e dhëmbëve dhe përgjatë rrënjëve të dhëmbëve. Kjo mund të dëmtojë përgjithmonë indet (ose "ligamentin periodontal") rreth dhëmbëve, si dhe kockën mbështetëse. Dhëmbët fillojnë të lirohen dhe përfundimisht mund të bien (8).

Kjo mund të shkaktojë probleme gjatë ushqyerjes dhe të folurit, si dhe të shkaktojë dëmtim kozmetik të buzëqeshjes suaj.

